



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Shkup, 28 shkurt 2025

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme në bilancin pagesor¹ në tremujorin e katërt të vitit 2024

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, në transaksionet rrjedhëse me jorezidentët është realizuar deficit prej 291,4 milionë euro, si rezultat i deficitit me këmbimin e mallrave dhe te bilanci i të ardhurave primare. Te transaksionet financiare me jorezidentët janë realizuar hyrje neto në bazë të huamarrjeve, investimeve direkte, kredive tregtare dhe valutave dhe depozitave, ndërsa daljeve neto në bazë të investimeve të portofolit.

Komponentët bazë të bilancit pagesor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në milionë euro)

	viti aktual					viti paraparak					ndryshimet tremujore		ndryshimet vjetore		ndryshim agregat	
	T.1 2024	T.2 2024	T.3 2024	T.4 2024	T.1-T.4 2024	T.1 2023	T.2 2023	T.3 2023	T.4 2023	T.1-T.4 2023	milionë euro	%	milionë euro	%	milionë euro	%
Llogaritë rrjedhëse	-196.8	-118.8	251.5	-291.4	-355.5	78.6	-126.7	229.1	-125.4	55.6	-542.9	...	-166.1	...	-411.1	...
Mallra	-817.0	-748.5	-644.6	-893.3	-3,103.4	-620.5	-596.4	-634.0	-783.2	-2,634.1	-248.7	38.6	-110.1	14.1	-469.3	17.8
Shërbime	303.0	242.8	370.1	146.0	1,061.9	254.3	14.5	292.9	173.9	735.5	-224.1	-60.6	-27.9	-16.0	326.4	44.4
Hyrje primare	-202.2	-198.8	-202.3	-197.6	-800.9	-183.0	-184.4	-189.6	-185.4	-742.4	4.7	-2.3	-12.2	6.6	-58.5	7.9
Hyrje sekundare	519.4	585.7	728.3	653.5	2,486.9	627.8	639.7	759.8	669.4	2,696.6	-74.8	-10.3	-15.9	-2.4	-209.7	-7.8
Llogaria kapitale	-1.0	0.5	-0.3	9.8	9.1	0.2	-0.5	-0.5	-0.1	-0.9	10.1		9.9		10.0	
Llogaria financiare	-192.3	-77.6	251.6	-212.3	-230.6	75.6	-119.8	256.5	-116.4	95.9	-463.9		-95.9		-326.5	
<i>Komponenta më të rëndësishme:</i>																
Investimet direkte	-277.0	-218.3	-237.6	-355.2	-1,088.1	-129.5	-119.7	-40.1	-198.8	-488.1	-117.5		-156.3		-600.0	
Krijimi neto i mjeteve	219.7	17.1	57.7	-307.0	-12.6	214.7	130.1	168.1	-407.9	104.9	-364.7		100.9		-117.5	
Kapital vetanak	28.1	30.9	31.3	41.9	132.3	15.2	22.1	19.0	23.5	79.8	10.6		18.5		52.5	
Riinvestim të fitimit	4.8	2.6	5.2	4.4	17.1	1.3	1.3	1.3	1.3	5.3	-0.9		3.1		11.7	
Instrumente të borshit	186.7	-16.4	21.1	-353.3	-161.9	198.2	106.6	147.8	-432.7	19.8	-374.5		79.4		-181.7	
Krijimi neto i detyrimeve	496.6	235.5	295.3	48.1	1,075.5	344.2	249.7	208.2	-209.1	593.0	-247.2		257.2		482.5	
Kapital vetanak	97.7	71.6	39.9	104.4	313.6	49.8	68.5	104.4	48.9	271.7	64.5		55.5		41.9	
Riinvestim të fitimit	144.6	87.2	27.2	-3.6	255.3	34.8	34.8	34.8	34.8	139.4	-30.8		-38.5		116.0	
Instrumente të borshit	254.4	76.6	228.2	-52.6	506.6	259.6	146.4	68.9	-292.9	182.0	-280.8		240.2		324.6	
Investime të portofolit	67.0	47.3	106.8	69.4	290.5	-438.5	20.0	414.9	37.6	34.0	-37.4		31.8		256.4	
Valuta dhe depozita	174.3	89.1	139.4	-18.3	384.5	124.0	120.1	268.1	-99.5	412.7	-157.7		81.2		-28.2	
Huamarrje	22.4	-48.3	66.3	-401.0	-360.6	163.7	-174.2	-8.1	-384.9	-403.5	-467.3		-16.1		42.9	
Kredi tregtare	114.3	37.7	183.4	-104.8	230.6	84.9	-17.7	-69.8	-63.6	-66.2	-288.2		-41.2		296.8	
Rezerva valutore	-291.9	15.4	-3.4	598.6	318.7	266.7	52.3	-308.7	592.8	603.1	601.9		5.8		-284.4	

...* Ndryshimi procentual është mbi 100

Shënim: Në llogarinë financiare shenja (-) shënon të hyra neto nga jashtë. Te rezervat valutore shenja (+) shënon rritje, derisa shenja (-) shënon uljen e mjeteve valutore. Në të dhënat për rezervat valutore janë përfshirur ndryshimet e çmimeve dhe diferencat e kursit.

Burimi: BPRM-ja.

Llogaria rrjedhëse

Nga aspekti i lëvizjeve të realizuara në komponente të veçanta të llogarive rrjedhëse, në tremujorin e katërt të vitit 2024, në transaksionet rrjedhëse me jorezidentët, ka pasur deficit në shkëmbimin e mallrave (893,3 milionë euro) dhe në të ardhurat parësore (197,6 milionë euro), që i tejkaloi hyrjet neto të të hyrat dytësore dhe ndryshimin e shërbimeve (653,5 , respektivisht 146 milionë euro).



¹ Bilanci pagesor është raport statistikor që përmbledh sistematikisht të gjitha transaksionet ekonomike të jashtme në Republikën e Maqedonisë së Veriut për një periudhë të caktuar kohore, përkatësisht, përmbledh transaksionet rrjedhëse, kapitale dhe financiare ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Përkundër suficitit në llogarinë rrjedhëse të realizuar në tremujorin e tretë të 2024 (251,5 milionë euro), në tremujorin e katërt është shënuar deficit prej 291,4 milionë euro, që tregon në rritje tremujore të flukseve neto dalëse në llogarinë rrjedhëse prej 542,9 milionë euro. Kushtet e tilla shpjegohen me rritjen sezonale të deficitit tregtar (248,7 milionë euro), si dhe me uljen e hyrjeve neto të shkëmbimi të shërbimeve dhe të ardhurat dytësore (për 224,1 , respektivisht 74,8 milionë euro), me ndryshim të matur pozitiv të të ardhurat primare (për 4,7 milionë euro).

Në krahasim me tremujorin e katërt të vitit të kaluar, deficitin në llogari rrjedhëse është rritur për 166,1 milionë euro, që në pjesë më të madhe lidhet me rritjen e deficitit në shkëmbimin e mallrave (për 110,1 milionë euro) dhe të ardhurat primare (12,2 milionë euro), si dhe në suficitin më të ulët të shkëmbimi të shërbimeve dhe të ardhurat sekondare (27,9 , respektivisht 15,9 milionë euro).



Burimi: BPRM-ja.

Në vitin 2024, llogaria rrjedhëse shënoi deficit në vlerë prej 355,5 milionë euro, që shënon rritje për 411,1 milionë euro, në raport me vitin 2023 dhe në pjesë më të madhe është rezultat i rritjes së deficitit në shkëmbimin e mallrave (469,3 milionë euro) dhe të ardhurave primare (58,5 milionë euro), si dhe uljes së suficitit të të ardhurat dytësore (për 209,7 milionë euro). Te shkëmbimi i shërbimeve është shënuar suficit më i madh për 326,4 milionë euro.

Llogaria financiare

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, te transaksionet financiare me jorezidentët janë realizuar hyrje neto prej 212,3 milionë eurosh. Hyrjet neto më të konsiderueshme janë realizuar te huamarrjet (401 milionë euro), investimet direkte (355,2 milionë euro), kreditë tregtare (104,8 milionë euro) dhe valutat dhe depozitat (18,3 milionë euro), përderisa neto-dalje janë vërejtur vetëm te investimet e portofolit (69,4 milionë euro). Rezervat valutore u rritën për 598,6 milionë euro.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Në tremujorin e katërt, te investimet direkte janë realizuar hyrje neto prej 355,2 milionë euro. Analizuar sipas komponentëve, arritjet e tilla janë rezultat i hyrjeve neto te borxhi ndërkompani (300,7 milionë euro), kapitali vetanak (62,5 milionë euro) dhe te riinvestimi i fitimeve (8 milionë euro). Në vitin 2024, mbi bazë të investimeve direkte janë realizuar hyrje neto në vlerë prej 1.088,1 milionë euro, që është rritje për 600 milionë euro në krahasim me vitin 2023. Me këtë, në vitin 2024, hyrje neto janë evidentuar te të gjithë komponentët, edhe atë: te borxhi ndërkompani (668,5 milionë euro), fitimi i riinvestuar (238,3 milionë euro) dhe kapitali vetanak (181,3 milionë euro).

Në tremujorin e katërt nga viti 2024, detyrimet mbi bazën e investimeve direkte² u rritën për 48,1 milionë euro, si rezultat i detyrimeve të rritura mbi bazën e investimeve në kapitalin vetanak (104,4 milionë euro), me uljen e detyrimeve mbi bazën e borxhit ndërkompani (52,6 milionë euro) dhe fitimit të riinvestuar (3,6 milionë euro). Gjithsej në vitin 2024, detyrimet kah investitorët direkt u rritën për 1.075,5 milionë euro, që është rritje për 482,5 milionë euro në raport me vitin 2023. Ndryshimi i përgjithshëm në raport me vitin 2023 është rezultat i rritjes së detyrimeve mbi bazën e borxhit ndërkompani (324,6 milionë euro), fitimit të riinvestuar (116 milionë euro) dhe kapitalit vetanak (41,9 milionë euro).

Në tremujorin e katër, mjetet mbi bazën e investimeve direkte janë ulur për 307 milionë euro, si rezultat i të arkëtueshmeve më të ulëta mbi bazën e instrumeteve të borxhit (353,3 milionë euro), me rritje të të arkëtueshmeve mbi bazë të kapitalit vetanak (41,9 milionë euro) dhe fitimit të riinvestuar (4,4 milionë euro). Gjithsej, për vitin 2024, mjetet mbi bazën e investimeve direkte janë ulur për 12,6 milionë euro. Për krahasim, në vitin 2023 është realizuar rritje prej 104,9 milionë euro. Ndryshimi i përgjithshëm në pjesë më të madhe rrjedh nga të arkëtueshmet më të ulëta mbi bazën e instrumeteve të borxhit (181,7 milionë euro), me rritjen e kapitalit vetanak (52,5 milionë euro) dhe fitimit të riinvestuar (11,7 milionë euro).

Investimet direkte në vend, në vitin 2024 shënojnë 1,255 milionë euro si rezultat i të hyrave neto te të gjithë nënkomponentet, edhe atë: instrumentet e borxhit (686 milionë euro), kapitali vetanak (313,6 milionë euro) dhe riinvestimi i fitimit (255,3 milionë euro). Në krahasim me vitin 2023 investimet direkte në vend shënojnë rritje për 677,2 milionë euro.

Në tremujorin e katërt të vitit, detyrimet neto mbi bazën e investimeve të portofolios janë ulur për 69,4 milionë euro. Ndryshimi i tillë në pjesë më të madhe lidhet para së gjithash me rritjen e investimeve të rezidentëve në letra me vlerë të borxhit të huaja, edhe atë nga ana e institucioneve të depozitave (53,7 milionë euro) dhe nga ana e institucioneve të tjera financiare (12,1 milionë euro).

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, hyrjet neto mbi bazën e borxheve nga 401 milionë euro në pjesë më të madhe janë rezultat i hyrjeve neto te sektori i "shtetit" (456,7 milionë euro), dhe në pjesë më të vogël edhe nga hyrjet neto te sektorët e tjerë³ (30,3 milionë euro), me daljet neto


² Investimet direkte shfaqen në varësi të faktit nëse transaksionet financiare krijojnë detyrim ndaj ose kërkesë (mjete) nga jashtë.

³ Sektorët tjerë përfshijnë: ndërmarrje tjera financiare, ndërmarrje jofinanciare, amvisëri dhe institucione jofitimprurëse të cilat ju shërbejnë amvisërive.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

nga aktivitete specifike të bankës qendrore që lidhen me menaxhimin me rezervat valutore (80,8 milionë euro) dhe te sektori i "institucioneve valutore" (5,3 milionë euro). Gjithsej për vitin 2024, hyrjet neto mbi bazën e borxheve shënojnë 360,6 milionë euro, me hyrje neto më të theksuara te sektori i "shtetit" (565,6 milionë euro) dhe te sektorët e tjerë (65,1 milionë euro), me daljet neto te banka qendrore (238,6 milionë euro) dhe te sektori "institucione valutore" (31,4 milionë euro).



Burimi: BPRM-ja.



Në vitin 2024, hyrjet neto të realizuara nga investime direkte (1.088,1 milionë euro) dhe borxhet (360,6 milionë euro), i tejkaluan daljet neto mbi bazën e valutave dhe depozitave (384,5 milionë euro), investimet e portofolit (290,5 milionë euro) dhe kredive tregtare (230,6 milionë euro), që mundësuan financim të tërësishëm të deficitit të llogarisë rrjedhëse nga 355,5 milionë euro dhe rritje të rezervave valutore për 318,7 milionë euro.

Rishikimi i të dhënave

Të dhënat për bilancin e pagesave në këtë njoftim përmbajnë rishikim të rregullt të të dhënave për periudhën janar - shtator 2024 me qëllim të përmirësimit të cilësisë së tyre. Njëkohësisht, rishikimi i të dhënave kontribuoi në rritjen e deficitit në llogarinë rrjedhëse për 32 milionë euro, kryesisht si rezultat i rishikimit të nën bilancit të shkëmbimit të mallrave dhe të ardhurave primare (deficit i rritur për 21,4 milionë euro, respektivisht 15,3 milionë euro), përkundër rritjes së suficitit të shkëmbimi i shërbimeve dhe të të ardhurat dytësore (për 3,4 milionë euro, respektivisht dhe 1,3 milionë euro).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Në llogarinë financiare, rishikimi ka çuar në rritje të të hyrave neto me 45,6 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së detyrimeve neto të kreditë tregtare (për 22,7 milionë euro), tek investimet direkte (për 17,8 milionë euro) dhe të borxhet (për 4 milionë euro).

Për shkak të rishikimit të të dhënave, ka pasur ulje të gabimeve dhe lëshimeve për periudhën janar – shtator 2024 për 12,5 milionë euro.

Informacione mbështetëse

Seri kohore e të dhënave: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për bilancin pagesor
https://www.nbrm.mk/platen_bilans-al.nspix

Shpjegime metodologjike: https://www.nbrm.mk/platen_bilans-al.nspix

Publikimet e ardhshme: Kalendari i publikimit të të dhënave
https://www.nbrm.mk/kalendar_na_objavuvanje_na_podatoci-al.nspix

Bilanci pagesor tremujor: 30 maj 2025 (periudhë referente, përfshirë marsin e vitit 2025).

Për pyetje të gazetarëve, ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 103 (ose 110/108).